



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

4/295

Datë:

16/11/2018

Universiteti i Prishtinës, në bazë të Rregullores nr. 2/294 të datës 14.11.2014 për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për ndarjen e bursave, pjesëmarrjen në konferenca shkencore nr. 3/542 dt. 19.12.2013, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 15.11.2018, mori vendim që të shpall:

## K O N K U R S

### Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2018-2019

#### I

#### Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve themelore (baçelor).
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
  - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
  - 2.2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
  - 2.3. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
  - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2016/17;
  - 2.5. Të kenë notë mesatare të studimeve më së paku **9.00 (nëntë pikë zero)**.
3. Përjashtimisht nga pika 2.5, studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Matematikës dhe Departamenti i Fizikës, mund të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ulët, por jo më pak se **8 (tetë)**.
4. Studentët të cilët në vitin akademik 2017/18 kanë pasur statusin e studentit me korrespondencë, nuk kanë të drejtë aplikimi për bursë universitare për vitin akademik 2018/19.

#### II

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:
  - 1.1. Kërkesën për aplikim dhe



- 1.2. Fletëparaqitjen (shkarkohet nga ueb-faqja e Universitetit).
2. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në zyrën e shërbimit të studentëve në fakultetet përkatëse.
  - 2.1. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
  - 2.2. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e sipërsënuara, shërbimi i studentëve në njësine akademike përkatëse nuk do t'iu lëshojë Fletëparaqitjen e cila ua mundëson aplikimin për bursë.
  - 2.3. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.
3. Bursat universitare për vitin akademik 2018-2019 nga rezultate e arritura të vitit akademik 2017/18 do t'u ndahen studentëve të nivelit baçelor, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë konkurs.
4. Lartësia e bursës do të jetë 600 € për secilin studentë përfitues.

### III Afati i aplikimit

1. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, përkatësisht prej datës **19. 11. 2018** deri më **03.12.2018** në orën 15:00.

### IV Afati i ankesave

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë anekese në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

Ankesat duhet të dorëzohen në zyrën nr.1, në ndërtesën e Rektoratit.

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve si dhe në ueb-faqen e Universitetit: [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu).

